




ALEANCA PËR FËMIJËT SHQIPËRI



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

KARTA RAJONALE RAPORTUESE – QARKU KORÇË

“Situata e fëmijëve me aftësi të kufizuar” për vitin 2011



QARKU KORÇË

Eksperte Rajonale
Mariana Jorgji

LISTA E SHKURTIMEVE

Observatori	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
ACA	- Aleanca Për Fëmijët në Shqipëri
DSHP	- Drejtoria e Shëndetit Publik
DRSHSSH	- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
OJF	- Organizata jo Fitimprurëse
FAK	- Fëmijë me Aftësi të Kufizuar
OMZH	- Objektiv i Mijëvjeçarit të Zhvillimit
MASH	- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
DAR	- Drejtoria Arsimore Rajonale
ZA	- Zyrë Arsimore
NJMF	- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
DRP	- Drejtoria Rajonale e Punësimit
PEI	- Program Edukativ Individual
OMZH	- Objektivat e Mijëvjeçarit për Zhvillim

I - Parathënie dhe falënderime

“Observatori për të Drejtat e Fëmijës” është një iniciativë ndërmjet UNICEF dhe “Aleancës për Fëmijët” (ACA), që ka ngritur mekanizmin për mbledhjen e informacionit dhe studimin e situatës së realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajoni.

Ky projekt ka filluar të zbatohet që në *Mars të vitit 2009*. Aktualisht Observatori ka ngritur zyrat në rang kombëtar, në të 12 qarqet e Shqipërisë. Zyra e Observatorit, harton raporte bazuar në realizimin e të drejtave të fëmijës me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke u mbështetur në analizën e 140 treguesve të ndryshëm.

Observatori Korçë ka ngritur urat e bashkëpunimit me të gjitha institucionet, drejtoritë, strukturat vendore dhe lokale si dhe OJF, të cilat kanë në fokusin e tyre fëmijët. Mund të përmendim disa prej tyre: Drejtorinë Arsimore Rajonale, Drejtorinë e Shëndetit Publik, Drejtorinë Rajonale të Punësimit, Drejtorinë e Policisë, OJF të ndryshme si dhe ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Bashkive dhe Komunave të qarkut.

Në rajonin e Korçës, Observatori ushtron veprimtarinë e tij që në Qershor të vitit 2009. Përveç mbledhjes së treguesve të drejtave të fëmijëve në sektorë të ndryshëm, si: arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale apo mbi të drejtën për pjesëmarrje, Observatori Korçë ka realizuar së fundmi studimin “Arsimimi dhe gjithë përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara” për vitin 2011. Ky studim vjen si një studim i bazuar në të dhënat e grumbulluara kryesisht nga fokus grupet në katër njësi administrative dhe gjithashtu nga të dhëna, statistika, informacione sasiore dhe cilësore të ardhura nga institucionet rajonale të qeverisjes vendore dhe nga organizatat e shoqërisë civile.

Studimi synon paraqitjen e tablosë së gjendjes së Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar (FAK) për vitin 2011 për Qarkun Korçë. Për realizimin e këtij studimi janë përzgjedhur katër njësi administrative, dy bashki dhe dy komuna. Konkretisht Bashkia Korçë dhe Maliq si dhe Komuna Pojan dhe Vreshtaz. Këto Bashki dhe Komuna janë përzgjedhur për shkak të numrit të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara krahasuar me njësitë e tjera administrative të Qarkut Korçë.

Gjithashtu problemet sociale me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuar janë të mprehta dhe akoma nuk ka një vëmendje të veçantë të treguar qoftë edhe nga pushteti lokal dhe qendror për të përmirësuar jetën e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Këtë fakt e tregon mungesa e buxheteve të veçanta për këtë kategori fëmijësh.

Observatori Korçë dëshiron të falënderojë për gjithë informacionet e vyera të dhënë në kuadër të realizimit të këtij studimi, të gjithë profesionistët e institucioneve rajonale të kontaktuar; prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar të intervistuar gjatë fokus grupeve; edukatorë e mësues të cilët synojnë integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në edukim. Gjithashtu një falënderim i veçantë është për Stafin e Aleancës Kombëtare për Fëmijë (ACA) përfaqësuar nga znj. Suzana Sakiqi si dhe znj. Elma Tërshana, (Drejtoreshë projekti), Znj. Mina Mata (Administratore kombëtare e të dhënave) për mbështetjen dhe këshillimet e vazhdueshme gjatë fazës së hartimit të këtij studimi; dhe Ermira Zace (Administratore dhe Financiere) për mbështetjen teknike të ofruar në çdo kohë.

II - Hyrja

Qarku i Korçës shtrihet në pjesën Juglindore të Shqipërisë. Ky Qark kufizohet me Qarkun e Elbasanit, Republikën e Maqedonisë në Veri dhe Veri-Perëndim, me qarkun e Beratit në perëndim, me Republikën e Greqisë në lindje dhe me qarkun e Gjirokastrës në Jug. Sipërfaqja e qarkut është 3,697 km² dhe e ndarë në 6 Bashki dhe 31 Komuna. Qarku Korçë në vitin 2011 numëron 352.088 banorë¹ ndërsa numri i fëmijëve të moshës 0-18 vjeç është 82.428 banorë, numër i cili është në rritje krahasuar me vitet e mëparshme.

Popullsia dhe migrimi i brendshëm është i orientuar më shumë drejt zonave urbane gjë që ka çuar rritjen e popullsisë në këto zona dhe braktisjen e zonave rurale. Përqindja më e madhe e popullsisë merret me bujqësi, kurse pjesa tjetër merret me industri agro-ushqimore, tekstile, shërbime tregtare, ndërtim, artizanat, transport, turizëm, arsim, shëndetësi dhe një pjesë shërben në administratën publike.

Ndryshimet social-ekonomike që kanë ndodhur në dhjetëvjeçarin e fundit janë shoqëruar me problematika të reja shoqërore, të cilat kanë sjellë pasoja në koston shoqërore për individë të pambrojtur, për familjet e tyre dhe komunitete të ndryshme. Shoqëria përballet me dhunën, problemet e shëndetit mendor, rritjen e krimit, përdorimin e drogës dhe të pijeve alkoolike, prostitucionin, trafikimin e qenieve njerëzore, shfrytëzimin e fëmijëve dhe përfshirjen tyre në format e këqija të punës.

Një tregues i këtyre ndryshimeve social-ekonomike, në fushën e studimit për të cilin është fokusuar Observatori, është rritja e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara sidomos i fëmijëve me diagnozën Autik. *Ajo çfarë vihet re është që shumica e fëmijëve autik vijnë nga familje emigrantësh.*

Qëllimi i këtij raporti është paraqitja e situatës së respektimit të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes vlerësimit të situatës dhe nevojave të tyre; Ky studim do të vinte në ndihmë ndërgjegjësimin e institucioneve përkatëse lokale për një planifikim më të mirë të nismave dhe veprimtarive në zonat problematike.

Gjithashtu ky raport studimor synon të identifikojë praktikën ekzistuese (nëse ka), shërbimet e pranishme si dhe situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në fushën e sociale për vitin 2011 në Qarkun e Korçës.

Ky studim do të bazohet në:

- Vlerësimin e nevojave fizike, strukturore, infrastrukturë të shkollave, të familjeve që kanë fëmijë me nevoja të veçanta, si dhe të ofruesve të shërbimeve qofshin këto publike apo jo-publike.
- Analizimi i nevojave dhe rekomandimet për ndërhyrjet e ardhshme të programit, vlerësuar nga pyetësorët dhe intervistat me aktorët përgjegjës.

Çështjet kryesore që ky raport ka marr në shqyrtim janë:

- Cilat janë nevojat e familjeve, prindërve dhe vetë fëmijëve me aftësi të kufizuara?
- Cilat janë nevojat e institucioneve arsimore apo institucioneve që ofrojnë shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara?
- Cili është niveli i arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta?

¹ Zyra e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, 2012

- Cili është niveli i përfshirjes në shërbime sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta?
- Cilat janë barrierat kulturore, institucionale dhe infrastrukturore që pengojnë arsimin cilësor të fëmijëve me nevoja të veçanta ose cenojnë integrimin e tyre në shoqëri ?
- Sa janë favorizuese politikat e ndërmarra për integrimin e të fëmijëve me nevoja të veçanta?
- Si mund të përmirësohet situata në të ardhmen për të garantuar respektimin e të drejtave të fëmijëve me nevoja të veçanta?

Ky studim ka përfshirë një kombinim të kërkimit në terren dhe analizimit të strategjive, dokumenteve politik, raporteve, ligjeve e publikimeve të ndryshme, në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Studimi synon paraqitjen e tablosë së kësaj situatë për vitin 2011 për Qarkun Korçë ku janë marrë në studim dy bashki dhe dy komuna (Bashkia Korçë dhe Bashkia Maliq, Komuna Pojan dhe Komuna Vreshtaz).

Ky studim analizon situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zonat e synuara dhe ofron një pasqyrë të plotë të burimeve ekzistuese, analizon situatën e fëmijës, familjes dhe komunitetit si dhe nevojat në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së këtyre fëmijëve. Gjetjet mbështeten në intervista dhe diskutime në grup me aktorët kryesorë, duke përfshirë edhe prindërit e fëmijëve, vëllezërit e motrat, mësuesit, ofruesit publike dhe private të shërbimeve (p.sh. përfaqësues të pushtetit lokal, përfaqësues të shëndetësisë, arsimi, OJQ-të lokale), etj.

Rezultatet e hulumtimit sugjerojnë për shumë përpjekje në këtë fushë. Institucionet Shtetërore dhe jo-shtetërore duhet të përmirësojnë praktikën ekzistuese, si dhe të krijojnë shërbime të reja. Rekomandimet e sugjeruara përfshijnë:

- aktivitete për ngritjen e kapaciteteve në çështjet e aftësisë së kufizuar,
- arsimi gjithëpërfshirës,
- përmirësimi i praktikave arsimore për të siguruar një shkollë miqësore për fëmijët me aftësi të kufizuara,
- përfshirja e prindërve,
- vlerësimin e nevojave dhe ngritjen e shërbimeve sociale nga ana e pushtetit lokal,
- përmirësimin e shërbimeve themelore dhe infrastrukturës për këta fëmijë,
- përforcimi i shoqërisë civile
- aktivizimi i burimeve ekzistuese, etj

1. Metodologjia e studimit

Për realizimin e këtij studimi u morën shumë të dhëna nga institucionet rajonale si: DAR; DSHP, DPQ, DRSHSSH si dhe nga OJF të ndryshme që operojnë në Qarkun Korçë. Gjithashtu shumë informacione sasiore por edhe cilësore u morën nga zhvillimi i fokus grupeve të realizuara, të cilat i shërbyen këtij raport studimi për të paraqitur edhe situatën reale të gjendjes së respektimit të drejtave të fëmijëve me nevoja të veçanta në Qarkun Korçë. Gjithashtu Metodologjia e këtij studimi përfshin një analizë të dyfishtë të kërkimit në terren dhe analizimit të dokumentacionit.

Një seri dokumentesh relevante u konsultuan gjatë fazës Desk Review si më poshtë:

- Strategjia Lokale për Personat me Aftësi të Kufizuar Bashkia Korçë 2009

- Strategjia Kombëtare për Njerëzit me aftësi të kufizuara 2004 – 2015
- Raporte të NJMF të Bashkisë Korçë.

Gjithashtu përmes pyetësorëve që përmbanin intervista gjysmë-të hapura është marrë informacion mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. 10 pyetësorë janë shpërndarë për secilin fokus grup të realizuar. Në këtë proces u përfshinë 35 persona. Megjithatë, studimi ka përfshirë një proces kërkimor më të gjerë me diskutime në grup me aktorët kryesorë, duke përfshirë edhe prindërit e fëmijëve, vëllezërit e motrat, mësuesit, ofruesit publike dhe private të shërbimeve. Në funksion të hartimit të raportit u zhvilluan edhe vëzhgime apo hulumtime në terren si: takim me Drejtore shkollash, mësues; administratorë social, përfaqësues të pushtetit lokal, specialistë të qendrave shëndetësore si dhe takime me prindër, fëmijë e fondacione (fondacioni Kennedy). Kjo metodologji ka përfshirë vizita në terren dhe takime formal dhe jo-formale me njerëzit lokalë që përfaqësojnë aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë. Pra, takime individuale dhe grupet e synuara u organizuan në çdo komunë dhe Bashki. Pyetje të përgjithshme dhe specifike u drejtuan me të gjithë aktorët dhe rezultatet u nxorën nga mendimet, faktet, vëzhgimet, qëndrimet e njerëzve, etj. Në **Aneks 1** gjendet Udhëzuesi për diskutimet në grupe dhe intervistat që janë kryer me çdo aktor gjatë studimit.

Ky studim për situatën e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në Qarkun Korçë për vitin 2011, pritet të ngjallë kureshtjen jo vetëm të organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime në këtë fushë por do të ndihmojë gjithashtu edhe njësitë e qeverisjes vendore dhe profesionistët e institucioneve rajonale që ta njohin më në thellësi çështjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Raporti adreson çështjet me të cilat mund të punohet për të përmirësuar situatën, duke synuar gjithashtu dhe orientimin e politikave favorizuese për këtë kategori për Qarkun Korçë.

III - Analiza e studimit

Tabela e mëposhtme jep një përshkrim të përgjithshëm të gjendjes së fëmijëve në zonat e synuara. Të dhënat janë marrë kryesisht nga raportet statistikore të Shërbimit Social Shtetëror dhe janë verifikuar në zyrat e administratorit sociale të komunës dhe zyrave të administratës shëndetësore. Nga diskutimet e realizuara me fokus grupet, deklarohet një numër i përafërt i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe jo të dhënat zyrtare të fëmijëve të diagnostikuar. Pikërisht, këto fëmijëve me aftësi të kufizuara që për shumë arsye nuk janë pjesë e sistemit të shërbimeve sociale, për rrjedhojë nuk përfitojnë nga asnjë shërbim.

Tabela 1: Përshkrim i numrit të fëmijëve me aftësi ndryshe në zonat e studiuara

Burimi: DRSHSSH Korçë

Bashki/Komunë	Nr total i fëmijëve 0-18vjeç	Nr total i FAK	Nr i FAK qe perf.pagesën e pafhtësisë(1)	Nr i FAK pa diagnozë	Nr i FAK qe Ndjekin shkollën	FAK që nuk ndjekin shkollën
Maliq	1878	~30	20	10	14	16
Pojan	4207	~113	91	21	64	49
Korçë	16.272	~74	66	8	45	29
Vreshtas	2851	~110	88	22	66	44

- (1)Pagesa qe shpërndahet nga komuna ne lek e cila mbulon shpenzimet baze te FAK. Shuma vendosen në varësi të diagnozës
- ~ përafërsisht – këto janë vlerësime të përafërta të nxjerra nga puna në terren si dhe intervistat ne fokus grupe . punonjësit e shëndetësisë dhe arsimit ishin ne dijeni të situatës se ka më shumë fëmijë pa diagnozë të cilën nuk ndjekin shkollën

Siç shihet edhe tabela nr.1 na jep të dhëna bazike mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuar që ndjekin apo jo arsimin. Nga DRSHSSH Korçë raportohet se nga 327 fëmijë me aftësi të kufizuar, janë 189 fëmijë që frekuentojnë shkollën dhe 138 që nuk e frekuentojnë atë. Përqindja e fëmijëve me aftësi të kufizuar për të gjitha njësitë administrative të përmendura në tabele, të cilët shkojnë në shkollë janë 57.8 %; ndërsa 42.2 % e këtyre fëmijëve nuk e frekuentojnë atë. Këto shifra tregojnë se akoma fëmijët me aftësi të kufizuar në Qarkun Korçë nuk janë të përfshirë në nivele optimale në arsim.

Tabela 2: Përshkrim i numrit të fëmijëve me paaftësi mendore dhe fizike
Burimi: DRSHSSH Korçë

Bashki/Komunë	Nr total i fëmijëve PAK	Nr I fëmijëve me paaftësi mendore	Nr I fëmijëve me paaftësi fizike
Maliq	20	12	8
Pojan	91	67	24
Korçë	66	37	29
Vreshtas	88	59	29

Koment: për shkak të mangësive në dokumentacion dhe diagnoze , mund të ketë edhe lëvizje në shifrat e lartpërmendura; 5 nga fëmijët me paaftësi mendore në Vreshtas, janë të diagnostikuar si autiste.

Në rajonin administrativ të Korçës pothuajse të gjitha shërbimet në dispozicion për këtë kategori sociale ofrohen vetëm në një shkollë shtetërore të quajtur “speciale” dhe një qendër e zhvillimit të vendosur në qytetin e Korçës. Përfshirja në këto qendra për njerëzit që jetojnë në komuna është shumë i kufizuar për shkak të distancës gjeografike si edhe kufizimet në numrin e përfituesve të këtyre qendrave.

Disa studime vlerësuese të kryera nga organizata jo-qeveritare ndërkombëtare si dhe OJQ kombëtare ose lokale kanë vërejtur se cilësia e shërbimeve në këto struktura shtetërore është shpesh jashtëzakonisht e varfër, e karakterizuar nga menaxhimi i centralizuar dhe jo ambiente të përshtatshme. Përveç kësaj, ky i fundit ka mungesa në pajisjet e duhura dhe stafit të kualifikuar, sidomos shërbimet për fëmijët me probleme në dëgjim dhe shikim.


Megjithatë, problemi i integritit të fëmijëve PAK në shoqëri është më i komplikuar në zonat rurale ku komunitetet kanë mungesë informacioni dhe mundësi të kufizuar për tu përfshirë në shërbimet ekzistuese. Si pasojë niveli i ndërjegjësisimit dhe integritit në lidhje me arsimin është

në minimum. Një faktor tjetër është edhe mungesa e infrastrukturës së përshtatshme. Është shumë e vështirë dhe ndonjëherë e pamundur që fëmijët me aftësi të kufizuara të udhëtojnë në qytet për të pasur përfshirje në shërbimet ekzistuese. Gjithashtu shkollat janë shumë të vjetra dhe infrastruktura e duhur apo e përshtatur “si mjedis miqësor social” mungon.

Është e dukshme dhe befasuese se shumë pak aktorë janë të përfshirë në fushën e integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Aktorët e shoqërisë civile kanë ofruar shërbime sporadike, të pakta dhe të pakoordinuara për të inkurajuar integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Disa prej tyre janë fondacioni Kennedy dhe World Vision të cilët kanë punuar me stafet arsimore për të përmirësuar shërbimet për fëmijët dhe organizuar aktivitete rekreative. Këto shërbime janë shumë të pamjaftueshme në krahasim me numrin në rritje të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët vazhdojnë të jetojnë në distancë nga pjesa tjetër e shoqërisë (ref grafikut 3).

Grafiku 3: Numri I fëmijëve me aftësi të kufizuara, Qarku Korçë

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror Tiranë



Prandaj, ekziston një nevojë e domosdoshme për të koordinuar përpjekjet midis aktorëve të shoqërisë civile në drejtim të iniciativave të reja, si dhe përmirësimin e atyre ekzistuese. Agjencitë e mbrojtjes sociale, si qeveritare dhe jofitimprurëse, duhet të koordinohen dhe të planifikojnë shërbime të përshtatura për të përmirësuar jetën e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe familjeve e tyre.

Iniciativa shtetërore dhe legjislacioni në fushën e aftësisë së kufizuar

Qeveria Shqiptare në vitin 2004 krijoi një strategji gjithëpërfshirëse dhe të re në fushën e arsimit për periudhën 2004-2015. Kjo strategji, ka integruar më së miri OMZH-të, "Arsim për të Gjithë", dhe ka vendosur shumë prioritete me qëllime gjithëpërfshirës. Ky vizion duket si një rrugë e drejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përkundër skepticizmit që ekziston për mundësinë për të qenë realisht një strategji e zbatueshme.

Në lidhje me arsimimin dhe përkujdesin shoqëror e social të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët janë integruar apo pritet të integrohen, vihen re shumë mangësi dhe probleme. Një problem i tillë është edhe mungesa e stafeve pedagogjike, specialist në fushën e aftësisë së kufizuar. Instituti Shqiptar i Studimeve Pedagogjike u ristrukturua, me qëllim funksionimin e tij në nivel rajonal. Ky ndryshim kishte për synim për të sjellë një decentralizimit të disa funksioneve shtetërore qendrore, me qëllim rritjen e efikasitetit në financimin e programeve arsimore. I tërë ky proces rezultoi në konfuzionet e shumta mbi rolet e reja dhe përgjegjësitë që dolën.

Në lidhje me perkujdesin shoqëror dhe social të fëmijëve me aftësi të kufizuar, është dhe udhëzim² i MASH (Ministria e Arsimit dhe Shkencës), i cili synon të sigurojë shërbime psikologjike dhe sociale në shkollë. Ky shërbim është i mundur dhe ofrohet në shkollat e zonave urbane (ku përsëri është një psikolog që mbulon 2 ose më shumë shkolla), por në shkollat e zonave rurale, në komuna, ky shërbim identifikohet të jetë i mangët. Zyrat arsimore e interpretojnë këtë si pamundësi fondi për të mbuluar me psikolog të gjitha shkollat në vend. Janë pikërisht këto shërbime të munguara, të cilat e vështirësojnë akoma më shumë situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuar, zhvillimin e potencialeve të tyre dhe integrimin si të barabartë në një shoqëri demokratike.

Gjithsesi, në Ligjin e ri të arsimit parauniversitar, parashikohet krijimi i komisioneve shumë-disiplinore rajonale³ me mandatin e vlerësimit të kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuar; një komision i cili gjithashtu sugjeron nëse fëmija mund të integrohet në shkollë normale apo në "shkollë të veçantë". Një grup i tillë tashmë ekziston në Korçë. Ajo udhëhiqet nga DAR Korçë dhe e mbështetur nga MEDPAK (OJF). Në këtë grup marrin pjesë profesionistë nga departamenti i shëndetit mendor, Departamenti i Arsimit, Pushtetit Lokal, OJQ-të lokale, prindërit dhe psikologu. Këta profesionistë vijnë së bashku dhe për të vlerësuar gjendjen e fëmijëve me aftësi ndryshe duke pasur parasysh, diagnozën, situatën familjare, zhvillimi etj. Ata japin një sugjerim për mbështetje të mëtejshme të secilit rast. Rastet nga zonat rurale nuk përfitojnë ende nga kjo nismë. Nga ky komision për qytetin e Korçës janë vlerësuar 19 fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët sot ndjekin kopshte dhe shkollat normale të qytetit. Tek ky komision u paraqitën edhe fëmijë të cilët nuk ishin drejtuar deri më sot tek institucionet shëndetësore.

Edhe pse ligji e përmend qartë ngritjen dhe funksionimin e këtij komisioni shumë-disiplinor, ky grup ekziston në disa qytete të Shqipërisë por ende nuk është shtrirë në zonat rurale. Pra fëmijët me aftësi ndryshe ose ndryshe fëmijëve me aftësi të kufizuar që vijnë nga këto zona nuk kanë mundësi të përfitojnë nga ky vlerësim.

Megjithatë, ligji i ri i Arsimit Para-Universitar i përmendur më lart gjithashtu thekson se raste të veçanta, si fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe që duhet të përfitojnë nga shërbimet arsimore alternative. Sipas Ligjit nr. 69/2012 "Për arsimin parauniversitar" këto shërbime⁴ përfshijnë shërbime psikologjike në institucionet e arsimit. Pushteti lokal në bashkëpunim me DAR janë përgjegjës për identifikimin dhe përfshirjen e çdo fëmije në sistemin arsimor normal dhe u sigurojnë atyre shërbim psikologjik-social. Fëmijëve me aftësi të kufizuar gjithashtu përfitojnë nga programet e edukimit special i miratuar dhe i përshtatur rast pas rasti duke u bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Gjithashtu bazuar dhe parashikuar në nenin 44 të po këtij ligji, Kurrikula të veçanta duhet të zhvillohen për fëmijëve me aftësi të kufizuar duke marrë parasysh zhvillimin fizik, social dhe mendor të fëmijës, si dhe kapacitetet individuale të çdo rasti. Në vazhdim të këtij ligji deklarohet se edukimi i fëmijëve në shkolla të veçanta duhet të jenë të përkohshme⁵, ndërsa integrimi në shkolla normale është themelore dhe duhet të jetë i përhershëm. Gjithashtu ZA-ve i lind

² Udhëzimi Nr.18 datë 21.04.2008 "Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar"

³ Ligji nr.69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar" neni 5 "E drejta për Arsimim" dhe neni 6 "Parimet e përgjithshme për edukimin e fëmijëve.

⁴ Neni 20 Ligji për Arsimin Parauniversitar, 2012

⁵ Neni 63, Ligji nr.69/2012 Për Arsimin Parauniversitar.

përgjegjësia e parashikuar në nenin 64 se duhet të ndërtojnë një komision të veçantë (të përmendur më lart, ekzistuese në Korçë) të përbërë nga mjeku specialist, profesionistë të arsimit, psikologë dhe përfaqësues të pushtetit lokal të cilët pas shqyrtimit të kërkesës së prindërve ose mësimeve të tyre, sugjerojnë dhe rekomandojnë vijueshmërinë e fëmijës dhe nëse ata duhet të frekuentojnë institucione arsimore të veçanta apo sistemin normal arsimor.

Gjithsesi është prindi ai i cili vendos nëse fëmija ndjek shkollën speciale apo arsimin normal. Institucionet arsimore të duhet të krijojnë dhe punojnë me programe edukative individuale (PEI). Ky plan përgatitet nga një komision i përbërë nga:

- mësues të fushave të ndryshme,
- psikologë dhe
- prindërve.

Fëmijëve me aftësi të kufizuara duhet t'u garantohet një mësues asistent dhe shërbime rehabilituese. Staf i arsimor që punon me këta fëmijë duhet të jenë të trajnuar dhe licencuar (certifikuar) nga MASH.

Në Nëntor të vitit 2010, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar edhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve - i cili thotë se çdo Bashki dhe komunë në Shqipëri duhet të krijojë zyrat e mbrojtjes së të drejtave të Fëmijëve. Këto Njësi të Mbrojtjes së fëmijëve (NJMF) janë përgjegjëse për menaxhimin, identifikimin, referimin dhe ndjekjen e çdo fëmije që rrezikon përjashtim social. Aktualisht më shumë se 30 NJMF janë krijuar në Shqipëri me mbështetjen e agjencive (ndërkombëtare) për mbrojtjen e fëmijëve. Një njësi e tillë është funksionale edhe në Bashkinë Korçë.

Shumë komuna kanë filluar për të krijuar këto zyra. Në zonat e pranishme, komunat ishin në dijeni të ligjit dhe të procedurave për krijimin e NJMF-ve. Ata kanë caktuar një nga administratorët socialë për të bërë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe funksionin e NJMF-ve.

Kjo është një shenjë e mirë për qeveritë vendore duke treguar vullnetin dhe përkushtimin, por këto zyra kanë nevojë për trajnime dhe mbështetje për zbatimin e duhur të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

Sipas Ligjit Para-Universitar (përmendur më lart) njësitë e qeverisjes vendore duhet të:

- Të mbështesin fëmijët në nevojë për të ndjekur shërbime adekuata arsimore
- Të sigurojnë që institucionet arsimore kanë kushtet e duhura fizike për FAK.
- Të mbështesin arsimin për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e kurrikulave për FAK
- Të bashkëpunojnë me ZA-të për braktisjen "Zero" etj.

Duke parë kuadrin ligjor mund të vlerësojmë se të drejtat e Fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të mirëpërcaktuara dhe të parashikuara në ligj. Ndërsa nga ana tjetër realizimi në praktikë i këtyre të drejtave akoma kërkon më shumë përpjekje dhe vëmendje në këtë fushë.

IV - Prezantimi i gjetjeve kryesore (Sasiore dhe cilësore)

Gjatë studimit është vërejtur se ka një mentalitet të vjetër të trashëguar nga regjimi komunist i cili është ende i dukshëm. Fëmijët me aftësi të kufizuara konsiderohen si subjekte për të ardhur keq apo fatkeqësi familjare. Gjatë punës në terren rezultoi se 50% e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zonat e synuara nuk ekspozohen në komunitet pasi janë prindërit dhe të afërmit të

cilët ndejnë paragjykimin në rastet e ekspozimit të fëmijëve duke çuar në izolim të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër është edhe ai grup prindëror të cilët nuk e pranojnë me lehtësi se fëmijët e tyre kanë aftësi ndryshe dhe shpesh i mbajnë fëmijët të marginalizuar brenda familjeve. Në lidhje me shërbimet komunitare që duhet të jenë prezente për ta bërë më të lehtë jetën për këta fëmijë, nuk evidentohet të jenë të ngritura e funksionale; ndërkohe që Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, Neni 30 përmend se:

“Fëmija me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike gëzon përkujdesje të veçantë e cila jepet falas nga autoritetet shtetërore . Ky përkujdesje i veçantë përcaktohet për ti siguruar fëmijës me aftësi të kufizuara qasje efektive në arsimim , trajnim, shërbime të kujdesit shëndetësor, shërbime të rehabilitimit përgatitje për punësim dhe argëtim ,duke zhvilluar mundësitë e tij individuale në mënyre të favorshme për arritjen e integritit të plotë të mundshëm social, kulturor dhe shpirtëror.”

V - Rekomandime

Ky studim synon të vlerësojë situatën e FAK dhe mundësitë e tyre për t'u regjistruar në sistemin arsimor normal dhe gjithë përfshirjen në jetën sociale. Është e qartë se ekziston një kuadër politik në vend, ka iniciativa qeveritare dhe agjenci që punojnë në këtë fushë, por realiteti tregon një situatë ende shumë e vështirë dhe detyra të porealizuara. Ka shumë fëmijë të pa diagnostikuar (si rrjedhim të paidentifikuar nga institucionet qeverisëse), të cilët nuk marrin asnjë shërbim publik dukë u mohuar dhe shkelur kështu edhe të drejtat e tyre. Këta fëmijë janë viktimat të mentalitetit të shoqërisë, të cilët nuk kanë pasur asnjëherë shans zhvillimi. Në shkollë, shumica e fëmijëve me aftësi të kufizuara ende viktimizohen. Ndërkohë mbetet shumë punë për të krijuar mjedise më miqësore për këta fëmijë; ata duhet të gjejnë mjedise të përshtatshme dhe ‘zhvilluese’ për t’u bërë pjesë e këtyre shërbimeve. Kjo është një pasqyrë e përgjithshme e situatës mbi të cilën janë bërë edhe vlerësimet e mundshme dhe mbi këto janë hartuar edhe rekomandimet për programe të mundshme ndërhyrjeje në këtë fushë:

- **Ngritja e kapaciteteve të personelit edukativ** në: Krijimin e Planeve Individuale Arsimore/Programet, krijimit të kurrikulave mësimore; sensibilizim në lidhje me ligjin dhe bashkëpunim me strukturat e pushtetit vendor, etj. Të gjithë mësuesit, psikologët e shkollave dhe punonjësit socialë duhet të trajnohen mbi pedagogjinë speciale dhe të certifikohen nga MASH në vlerësimin dhe ndërtimin e programeve individuale për fëmijëve me aftësi të kufizuara. Një mangësi të dukshme sjell fakti që shkollat e komunave, nuk përfitojnë nga shërbimi psikologjik – kështu ekziston nevoja për të zgjeruar këtë shërbim ose gjetur zgjidhje alternative. Megjithatë, disa mësues janë trajnuar në ndërtimin e planeve individuale arsimore, por trajnimet duhet të jetë e vazhdueshme dhe të sigurojnë ndjekje rast pas rasti. Asnjë prej këtyre mësimeve nuk është certifikuar (licencuar) nga MASH dhe nuk ka bashkëpunuar me strukturat e pushtetit vendor për gjetjen e zgjidhjeve për rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Duhet të organizohen trajnime të përbashkëta të gjithë aktorëve dhe duhet ndërtuar një plan veprimi lokal për të përmirësuar jetën e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- **Shkolla si qendër informimi.** Shumë prindër thonë se ata merren me problemin të vetëm. Ata duhet të marrin vendime shumë herë duke mos ditur opsionet. Në shumicën e rasteve prindërit nuk janë sensibilizuar në lidhje me situatën dhe të drejtat të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe shanset e tyre për zhvillim. Në një situatë të tillë shkolla duhet

të luajë një rol informativ. Duhet të ketë një qendër informacioni brenda secilës shkollë me mandatin e informimit qytetar në lidhje me të drejtat, shërbimet dhe burimet në dispozicion që familjeve e fëmijëve me aftësi të kufizuar duhet të përdorin për të përmirësuar jetën e tyre. Kjo qendër duhet të luajnë edhe rolin e koordinimit të veprimeve me institucionet e tjera, si dhe agjencitë jo-qeveritare për menaxhimin sa më të mirë të rasteve dhe shërbimit të fëmijëve dhe familjeve të tyre.

- **Sensibilizimi i Prindërve.** Shkollat, pushteti lokal, OJF-të dhe agjencitë e mbrojtjes së fëmijëve duhet të aktivizohen për të sensibilizuar prindërit dhe për të thyer mentalitetet e vjetra. Bazuar në parimet e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë në të gjitha aspektet e jetës. Ata duhet të marrin pjesë në shoqëri njësoj, duhet të përfshihen në arsim, të kenë qasje në shërbimet në dispozicion, të argëtohen, të zhvillohen etj. Disa nga prindërit, nuk janë të informuar edhe për shërbimet në dispozicion, ata nuk diagnostikojnë fëmijën apo edhe refuzojnë ndihmën ekonomike për këto shkaqe. Prindërit duhet të jenë të sensibilizuar që paaftësia e fëmijës nuk është një faj ata janë pjesë e barabartë e shoqërisë. Është e domosdoshme që prindërit duhet të informohen për diagnozën e fëmijëve, zhvillimet e mundshme dhe nevojat e fëmijës, dhe pastaj të bëjnë të mundur që ata të luajnë rolin e tyre në shoqëri. Është në fakt përgjegjësi e të gjithëve për të ndihmuar situatën dhe për të qenë përkrah prindërve që për të ndërmarrë hapa përpara.
- **Sensibilizimi i Fëmijëve.** Nga diskutimet në fokus grupe e zhvilluara u evidentua fakti se fëmijët e shkollave mbajnë distancë nga fëmijëve me aftësi të kufizuar në mjediset shkollore. Është e qartë se mentaliteti i vjetër i prindërve ndikon tek sjelljet dhe qëndrimet e fëmijëve. Pra, nëse vërtet duam të krijojmë ambiente dhe shkolla miqësore për fëmijëve me aftësi të kufizuar duhet të bëjmë shumë punë për të ndikuar në qëndrimet e fëmijëve të moshës shkollore. Kjo është esenciale për të mirëpritur fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollë dhe për të pasur një shans të vërtetë në sistemin edukativ. Shkolla duhet të luajë rolin e 'sensibilizuesit komunitar' - informacioni që merret në shkollë është shumë i rëndësishëm për të gjithë komunitetin dhe mesazhe të shkollës miqësore për fëmijëve me aftësi të kufizuar duhet të jenë atje. Kjo mund të bëhet përmes metodave të mësimdhënies, organizatave të shoqërisë civile; projektet e fëmijëve dhe reflektimi, teatër dhe role-playing, trajtimet të aspekteve të arsimit gjithëpërfshirës gjatë orëve mësimore shkollore, etj
- **Forcimi i organizatave të shoqërisë civile.** Në të gjitha zonat e synuara pjesëmarrja apo përfshirja e organizatave të shoqërisë civile ishte shumë pak e pranishme. Personeli arsimor deklaroi se ka pasur disa kontakte me disa OJQ, por asnjë prej tyre nuk ishte organizatë lokale me shërbime të mirëfillta. Siç është përmendur në edhe më lart, prania dhe mbështetja e organizatave aktive të shoqërisë civile apo mbështetje e qytetarëve aktivë që janë në gjendje për të bërë një ndryshim në jetën e fëmijëve me aftësi të kufizuar është shumë e rëndësishme. Duhet inkurajuar grupet e komunitetit, mësuesit apo organizatat e prindërve për të luajtur një rol në jetën e këtyre fëmijëve. OJF-të me përvojë nga ana tjetër (eksperte në këtë fushë) si MEDPAK, Kennedy Foundation, etj, duhet të mbështeten që të ndërhyjnë dhe të fillojnë aktivizimin e komunitetit. Duhet të gjenden mënyra jo vetëm për të sensibilizuar komunitetin dhe influencuar mentalitetin, por edhe për të advokuar për më shumë shërbime, më shumë aktivitete social-kulturore, lobim tek strukturat qeveritare për zbatimin e duhur të Ligjit për arsimin gjithëpërfshirës etj.

- **Krijimi i Qendrave me bazë Komuniteti.** Për shkak të aktivitetit të kufizuar të shoqërisë civile dhe jo të shpërndare njëtrajtësisht në të gjitha zonat e vendit, është evident që qendrat informative apo të komunitet nuk ekzistojnë në zonat e synuara. Disa nga intervistuesit kanë përmendur se një qendër e tillë është e nevojshme për të luajtur rolin e mobilizimit komunitar dhe për të shërbyer si një vend takimi për shkëmbim informacioni, sensibilizim dhe aktivitete rekreative për fëmijëve me aftësi të kufizuar. Infrastruktura e këtyre komunave është shumë e dobët dhe nuk lejon për zhvillimin e aktiviteteve zbavitëse ose aktiviteteve sociale - këto mund të zhvillohen në një qendër komunitare burimore për fëmijëve me aftësi të kufizuar. Kjo qendër mund të jetë edhe një model i parë i një vendi miqësor për fëmijëve me aftësi të kufizuar i cili do të reflektojë edhe mundësinë për t'i kthyer edhe shkollat në ambiente të tilla. Grupe studentore, organizata të shoqërisë civile, mësuesit, etj mund të tregojnë , se pjesëmarrja e plotë është e mundur dhe arsimi gjithëpërfshirës e bën jetën tonë më të pasur.
- **Rritja e efikasitetit të Komitetit të Vlerësimit të Nevojave për fëmijët me aftësi të kufizuar.** Një organizëm i tillë i vendosur në DAR duhet të vlerësojë fëmijët me aftësi ndryshe edhe në komuna. Ky komitet është tashmë ekzistues në Korçë i cili rregullohet nga Ligji dhe mbështetet aktualisht nga MEDPAK. Anëtarët e komisionit janë ekspertë të fushave të ndryshme dhe janë të trajnuar në vlerësimin e nevojave individuale të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Ai vlerëson situatën e fëmijës dhe sugjeron për ndërhyrje të mundshme apo zhvillimin e programeve individuale rast pas rasti. Fëmijët në zonat e synuara duhet të përfitojnë nga ky komitet dhe sugjerimet duhet të paraqiten tek prindërit dhe punonjësit social. Në varësi të vlerësimit, fëmijët e aftë të ndjekin arsimin normal duhet të mbështeten më tej për të ndjekur shkollat lokale.
- **Ngritje kapacitetesh profesionale.** Personeli i DSHP-së mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuar. Jo vetëm ata mund të luajnë një rol të rëndësishëm informativ dhe ndërjegjësuës tek prindërit për kontroll të rregullt gjatë shtatzënisë dhe diagnozifikim të hershëm, por ata mund të informojnë prindërit e rinj për aftësinë e kufizuar të fëmijëve dhe trajtimet specifike që ata kanë nevojë. Qendrat komunale shëndetësore duhet të mbajnë dosje të veçanta për çdo fëmijë me aftësi të kufizuar (e cila mungonte në qendrat e vizituara) dhe për të mbajtur një histori të rregullt të përditësuar të fëmijës. Kjo përfshin llojin e shenjave të aftësisë së kufizuar, trajtimin, disa aspekte sociale, etj. Megjithatë, fletëpalosje informative duhet të jetë në dispozicion në këto qendra për informimin prindërit në shërbimet e mundshme, si dhe palët e interesuara që mund të jetë ndihmë për të kontaktuar. Me gjithë këto, duhet të ketë një personel të trajnuar të veçantë i cili ndjek të gjitha rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe i raporton institucioneve të tjera mbi ecurinë dhe situatën e fëmijës.
- **Në varësi të diagnozës** është sugjeruar që fëmijëve me aftësi të kufizuar të përfitojnë edhe shërbimet e shkollës speciale në Korçë. Kjo është një shkollë speciale rajonale e ndjekur nga fëmijët me aftësi të kufizuara specifike (zakonisht fëmijët me pak shanse zhvillimi). Kjo shkollë nuk është një model në fushën e aftësisë së kufizuar, por ka hapësirë në dispozicion dhe staf të përkushtuar për të bërë një ndryshim. Strukturat qeveritare dhe jo-qeveritare duhet të koordinojnë veprimet dhe të investojnë në bërjen e kësaj shkolle një qendër për zhvillimin e fëmijës me aftësi ndryshe. Me disa përpjekje shkolla mund të transformohet në një qendër edukative, rekreative dhe komunitare për

këta fëmijë dhe familjet e tyre. Kjo është një qendër e përkohshme edukative ; fëmijët përfitues pasi marrin shërbimin e duhur mund të ndjekin edhe arsimin normal, pas një vlerësimi pozitiv. Komiteti i Vlerësimit të Nevojave pranë DAR-së vendos për këtë pas ekzaminimit të zhvillimit të fëmijës.

- **Përmirësimi i shërbimit** dhe qasjes në qendrën rajonale të zhvillimit (Atelie) në Korçë. Kjo është një tjetër qendër shërbimesh për fëmijët me aftësi të kufizuar në qytetin e Korçës. Sigurisht që shërbimet e ofruara janë të cilësuar si “bazike” (aktivitete rekreative, 1 vakt ushqimor, 2-3 ekskursionet në vit), por ajo shërben si një qendër komunitare dhe një vend për të takuar njerëz të tjerë dhe shkëmbyer informacion. Aktualisht ekziston një kufi në numrin e fëmijëve që frekuentojnë qendrën, por ajo mund të përdoret edhe nga fëmijët e komunave.
- **Transporti publik dhe infrastruktura.** Kontrollat mjekësore, diagnostikimi dhe shërbimet tjera publike kërkojnë transport të fëmijëve me aftësi të kufizuar në Korçë apo qytete të tjera. Transportimi i këtyre fëmijëve shpesh është shumë i vështirë sidomos për fëmijëve me aftësi të kufizuar fizike. Autobusët nuk janë të përshtatur dhe miqësorë për fëmijëve me aftësi të kufizuar. Infrastruktura e ndërtesave është një tjetër pengesë për përfshirje në shërbimet dhe zhvillimin të këtyre fëmijëve.
- **Advokimi për zbatimin e ligjit të arsimit gjithëpërfshirës** - Një tjetër aspekt i rëndësishëm në kuadrin e zhvillimit fëmijëve me aftësi të kufizuar është lobimi për zbatimin e drejtë të Ligjit të Arsimit Parauniversitar. Siç u tha më sipër Ligji thotë qartë se shkolla duhet të ketë një punonjës social apo psikolog dhe klasa duhet të ketë një mësues asistent për të ndihmuar mbarëvajtjen shkollore të këtyre fëmijëve. Deri tani, nuk ka modele të tilla në zonat e synuara. Shkolla, shoqëria civile dhe drejtoritë rajonale të arsimit duhet të luajnë një rol në përmirësimin e kësaj situate.
- **Forcimi i NJMF në komuna** për identifikimin dhe ndjekjen e rasteve. Raporti thekson qartë se një aktor i rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar është qeveria lokale. Kohët e fundit çdo komune dhe bashki në Shqipëri ka emëruar apo ka ngritur Zyra të Mbrojtjes të fëmijëve me mandatin e identifikimit, referimit dhe menaxhimit të çdo rasti të fëmijëve në rrezik. Në zonat e studiuara janë emëruar punonjës me këtë mandat të cilët kanë nevojë për ngritjen e kapaciteteve; qartësimin e detyrave dhe mbështetje për ndjekjen e rasteve. Është e qartë se këto fëmijë janë aktualisht një kategori e pambrojtur dhe në rrezik përjashtimit social. Në këtë kuadër NJMF-të duhet të mbledhin të dhëna, informacione, bazë të dhënash dhe duhet të fillojnë punën për krijimin e shërbimeve të qëndrueshme për këta fëmijë. Ata duhet të bashkëpunojnë ngushtë me agjencitë kombëtare dhe ato ndërkombëtare të mbrojtjes së fëmijëve dhe të raportojnë të dhënat dhe situatën si dhe të bëjnë thirrje për mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuar sipas nevojave dhe mundësive lokale.
- **Buxhete të veçanta** për aktivitetet social-kulturore (kampe verore, ditët informative, etj) më qëllim gjithë përfshirjen sociale të akorduara nga Bashkitë dhe komunat. Është e domosdoshme që buxhetet lokale të reflektojnë përmbushjen e disa përgjegjësive për fëmijëve me aftësi të kufizuar në aspekte të ndryshme. Është e nevojshme jo vetëm përmirësimi fizik i shkollave (me terrene sportive dhe të përshtatur për fëmijët me aftësi të kufizuar) por edhe aktivitetet që ndihmojnë këto fëmijë të përmirësojë pjesëmarrjen e

tyre në shoqëri. Duke qenë një grup në rrezik përjashtimi social - një vëmendje e veçantë duhet të ketë nga qeveritë vendore dhe institucionet e tjera të rajonit (Qarku dhe Prefektura) për më shumë fonde për fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ekziston një strategji për mbrojtjen sociale të miratuar nga parlamenti shqiptar - por nuk ka fond të alokuar dhe të reflektuar në buxhetet lokale. Është e domosdoshme që strukturat qeveritare të aktivizojnë institucionet dhe shoqërinë për të bërë më shumë për këtë, por është qeveria lokale e sociale duhet t'u shërbejnë drejtpërdrejt këtyre njerëzve si qytetarë të barabartë. Aktivitete si kampet verore, ditë informative, aktivitete të ndërgjegjësimit apo mbështetje për organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë pjesë e buxhetit vendor.

- **Vizita studimore për shkëmbimin e praktikave më të mira.** Pavarësisht situatës aktuale duhet thënë se ka hapa të suksesshëm në këtë fushë. Ka organizata aktive dhe agjenci në Shqipëri që po punojnë në fushën e zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Për shembull MEDPAK, Fondacioni Kennedy, Kombet e Bashkuara, etj kanë shtyrë për progres të konsiderueshëm në fushën e arsimit gjithëpërfshirës. Njohuritë ekzistuese dhe praktikat e mira për përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve të zbatuara në qytete të tjera mund të përdoren edhe në zonat e synuara. Disa projekte janë zbatuar nga MEDPAK në disa komuna dhe Bashki të Shqipërisë në kuadër të ngritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të shërbimeve për inkurajimin e arsimit gjithëpërfshirës. Kjo përvojë mund të shkëmbehet nëpërmjet vizitave dhe seminareve të përbashkëta në mënyrë që të mësohet nga sukseset dhe eksperiencat e kaluara.

KONKLUZIONE

*Përfundimi më i rëndësishëm i këtij studimi është përforcimi i përpjekjeve koordinuese me ndërhyrje në tre akse kryesore: **pushteti lokal, institucionet arsimore dhe shoqëria civile natyrisht duke punuar bazuar në parimet e interesit më të lartë të fëmijëve.***

Në varësi të zonës dhe situatës duhet të identifikohen aktorët / strukturat të cilat duhet forcuar dhe sigurisht qëndrueshmëria e ndërhyrjeve (p.sh. njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, drejtorët e shkollave, organizatat e prindërve, etj) dhe me pas të inkurajohen krijimet e bashkëpunimeve lokale institucionale duke nxitur bashkëpunime që krijojnë një energji të përbashkët funksionale. Pra, një program që synon përmirësimin e të tre akseve të lartpërmendura (apo struktura brenda tyre (NJMF, DAR, organizata me baze komunitare, etj) dhe nxit bashkëpunim midis tyre (i cili mbështet edhe me ligj) do të jetë hapi i parë i qëndrueshëm drejt përmirësimit të situatës.

Sigurisht që strukturat ekzistuese dhe praktikat janë shumë të rëndësishme, por në rastet kur ato mungojnë duhet më vlerësimin të situatës dhe shkëmbime të praktikave të mira në këtë fushë. Vlen të theksohet pozitivisht është se nga ana lokale ka burime në dispozicion dhe njerëz të gatshëm për të ndryshuar situatën. Kjo tregon për një terren të mirë pune dhe gatishmërinë për të filluar një program ndërhyrjeje.

Një manual i një shkolle miqësore për FAK mund të zhvillohet me përshkrime të praktikave ekzistuese dhe histori suksesi në këtë fushë. Gjithashtu ky dokument duhet të jetë një manual që përshkruan të gjitha hapat e nevojshme dhe aktorëve të përfshirë për të krijuar një mjedis miqësor në shkollë. Ky udhëzues mund të jetë i dobishëm për shpërndarjen e përvojave dhe ndarjen e praktikave në Komunitat dhe Bashkitë e tjera në Shqipëri.

Aneks 1

Udhëzuesi për Diskutimet në Grupe dhe Intervistat me aktorë të ndryshëm.

Mjetet e përdorura	Qëllimi	Pjesëmarrësit
Intervista Individuale	Te kuptojmë drejt: a. Opinionet e njerëzve ne terren b. Eksperiencat e fëmijëve , autoriteteve lokale, shkollave, etj	Eksperti, përfaqësues te zyrave shëndetësore, komuna, shkolla, etj
Diskutimet ne grup	Eksploron aspekte të paqarta të fushës së aftësisë së kufizuar; dëshirën e njerëzve për të ndryshuar gjërat, etj	
Vëzhgime/eksperienc të shkuara	Vëzhgon sinergjitë ë krijuara ndërmjet autoriteteve lokale , zyrave shëndetësore, shkollës dhe aftësinë e tyre për të bashkëpunuar në të ardhmen;	

BIBLIOGRAFIA

1. Strategjia Lokale për Personat me Aftësi të Kufizuar Bashkia Korçë 2009
2. Strategjia Kombëtare për Njerëzit me aftësi të kufizuara 2004 – 2015
3. Raporte të Zyrës së Mbrojtjes së Fëmijëve; Korçë